



# Lake Shkoder-Skadar

## INTEGRATED ECOSYSTEM MANAGEMENT PROJECT

### Në brendësi

<i>Pak fjalë për projektin MIELSH</i>	1
<i>Komisioni i Liqenit të Shkodrës</i>	1
<i>Grupet e përbashkëta të punës</i>	2
<i>Administrimi i Zonave të Mbrojtura</i>	2
<i>Studime dhe Raporte</i>	4
<i>Të reja</i>	4

## Pak fjalë për projektin MIELSH

Projekti “Menaxhimi i Integruar i Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës” - MIELSH—është një nga projektet e Bankës Botërore (BB), i financuar nëpërmjet Grantit të Veçantë të Investimeve nga Fondi Global i Mjedisit (GEF) si dhe nga kontributi i Buxhetit të Shtetit, i cili synon të mbështesë strategjinë e hartuar për këtë zonë. Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të ruhen dhe të përmirësohen vlerat ekonomike afatgjata dhe shërbimet mjedisore të Liqenit të Shkodrës si dhe burimet e tij natyrore. Projekti synon të realizojë këtë objektiv duke:

a) forcuar mekanizmin institucional për koordinimin dhe kooperimin ndërkufitar;

b) përmirësuar informacionin dhe njohuritë për ekosistemin e liqenit si dhe ndikimin

potencial të zhvillimit; dhe c) demonstruar e nxitur reduktimin e ndotjes dhe duke fuqizuar kapacitetet rregulluese.

Projekti mbështetet në tre shtylla kryesore:

- 1) ngritje kapacitetesh për kuptim dhe menaxhimin të përmirësuar të liqenit i cili synon të krijojë dhe të funksionojë Komisioni i Liqenit të Shkodrës, Sekretariatit e tij dhe Grupet Bilaterale të Punës;
- 2) Të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të liqenit i cili do të çojë në promovimin e adoptimin e metodave të qëndrueshme drejt zhvillimit ekonomik të liqenit (dhe të burimeve të tij natyrore) duke u fokusuar në turizëm dhe në peshkim; dhe
- 3) Nxitja e investimeve për reduktimin

e ndotjes së ujit i cili do të mbështesë investimet e përzgjedhura e do të stimulojë aktivitete për reduktimin e mbetjeve. Një nga rezultatet e pritshme të projektit është që të vendosë një sistem efektiv për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, përfshirë edhe peshkimin. Peshqit janë burimi natyror më domethënës në liqenin e Shkodrës për sa i përket ekonomisë lokale dhe punësimin. Është evidentuar që disa nga speciet më të vlefshme të peshqve të liqenit janë të kërcënuara dhe janë duke u zvogëluar nga shfrytëzimi i tepër dhe nga degradimi i habitateve, veçanërisht nga rritja e numrit të peshkatarëve aktiv.



## Komisioni i Liqenit të Shkodrës

Komisioni i Liqenit të Shkodrës (SLC) është një strukturë e përbashkët e themeluar me një marrëveshje të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit të Malit të Zi dhe Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Liqenit të Shkodrës. Sekretariati i përbashkët e ka selinë në Shkodër dhe ka rol koordinues ndërmjet komisionit, katër grupeve të punës, qeverisë, donatorëve dhe komunitetit rreth liqenit. Pjesëtarët e komisionit janë të emëruar nga të dy ministritë dhe Kryetari i Komisionit vendoset

me rotacion ndërmjet të dy vendeve. Për 2011 Komisioni drejtohet nga Shqipëria. Komisioni ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm duke përgatitur marrëveshje bilaterale, nënshkruar dokumente por edhe gjatë situatave emergjente siç ishte përmbajtja në Dhjetor 2010 dhe Janar 2011 duke koordinuar dhe menaxhuar masat që duhen marrë në të ardhmen. Projekti është duke mbështetur financiarisht punën e komisionit, të grupeve të punës dhe të sekretariatit, por që nga viti 2012 këto struktura të përbashkëta institucionale do të

mbështeten financiarisht nga të dy qeveritë. Anëtarët e SLC janë:

- Z. Sajmir Hoxha**, kryetar, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- Z. Ridvan Trashani**, Bashkia Shkodër;
- Z. Fatbardh Sokoli**, Shoqëria civile;
- Z. Sinisa Stankovic**, Ministria e Turizmit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Z. Zoran Mrdak**, Parku Kombëtar i Liqenit të Shkodrës;
- Z. Marko Junkovic**, shoqëria civile; Sekretari i Komisionit është **Z. Ilir Kraja**.

### Histori të Suksesshme

- Menaxhimi i peshkimit të qëndrueshëm
- Fushata e përbashkët për ndërgjegjësimin e publikut

## Grupet e përbashkëta të punës



Në kuadër të projektit në vitin 2009 janë themeluar dhe funksionojnë katër Grupe të Përbashkëta Pune. Këto struktura të përbashkëta funksionojnë bazuar në një marrëveshje të përbashkët ndërmjet dy vendeve dhe qëndrueshmëria e tyre do të varet nga aktivizimi i aktorëve dhe strukturave lokale pasi projekti të ketë përfunduar.

Roli i Grupeve të Përbashkëta të Punës është aksioni i përbashkët dhe kontribut teknik në dokumentat e lidhur me mbrojtjen e mjedisit, burimeve natyrore dhe ekosistemit ndërkufitar nga të dy vendet përgjatë dhe pas përfundimit të projektit.

Grupet e Punës përbëhen nga dhjetë ekspertë nga organizatat e shoqërisë civile, Universiteti, administrata lokale dhe aktorë kyç nga të dy vendet. Ata janë zyrtarisht të mbështetur nga Sekretariati i Komisionit të Liqenit dhe takohen 2-3 herë në vit në Shkodër ose në Podgoricë për të diskutuar aspekte të ndryshme teknike të aktiviteteve të projektit dhe për të propozuar ide apo çështje të reja për tu përfshirë në programet e aktorëve lokal në të dy vendet.

Kontributi dhe ekspertiza e tyre ka qenë vendimtare jo vetëm në përpilimin e termave të referencës për

detyra të ndryshme teknike të projektit por gjithashtu edhe në rishikimin e plotësimin e studimeve të përgatitura nga konsulentë vendas e të huaj.

Mund të përmenden studime si: Rishikimi Kuadrit Ligjor; Niveli i Eutrofikimit të vëzhgimit të ujit të liqenit; Programi i Përbashkët i Monitorimit të Liqenit; Plani i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura; Modeli Parashikues Hidrologjik i Pellgut të Liqenit; Vëzhgim mbi peshkimin e paligjshëm; Vlerësimi Socialo-Ekonomik; etj.

Një nga rezultatet e punës së Grupeve të Punës ka qenë identifikimi dhe pajisja nga projekti MIELSH, i Universitetit të Shkodrës si dhe rojeve të liqenit me mjetet e nevojshme për mbrojtjen dhe monitorimin ndërkufitar të ujërave të liqenit.

Diskutimet në takimet e grupeve janë me vlera dhe të frytëshme edhe për bashkëpunimin e dyanshëm.

Grupet e Punës janë:

- i) Monitorimi dhe Kërkimi,
- ii) Komunikimi, Publiku dhe Promovimi i Turizmit,
- iii) Legjislacioni dhe Planifikimi,
- iv) Administrimi i Ujërave

## Administrimi i Zonave të Mbrojtura

Administrata e Zonave të Mbrojtura (AZM) – është iniciuar nga projekti mbi Menaxhimin e Integruar të Ekosistemit në Liqenin e Shkodrës. Struktura e saj është përgatitur me mbështetjen dhe asistencën e Bankës Botërore dhe e miratuar nga Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Adminsitrimin të Ujrave. Administrata e Zonave të Mbrojtura është pjesë e Drejtorisë së Mbrojtjes së Pyjeve. Projekti MIELSH ka qenë një vlerë e shtuar për zonat e mbrojtura – tha Z. Ridvan Hebah, Drejtor i Adminsitratës së zonave të mbrojtura.

Kooperimi ndërmjet AZM dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkut forcoi monitorimin dhe mbrojtjen e Liqenit. Pajisjet e nevojshme dhe mbështetja teknike janë ofruar për të rritur dhe forcuar performancën e administratës dhe të kapaciteteve të njësive rojtare të pyjeve.

Shoqata për Mbrojtjen e Gjallesave Ujore në Shqipëri po punon së bashku me administratën për të përgatitur një plan menaxhimi dhjetë (10) vjeçar dhe një plan aktiviteteve pesë (5) vjeçar. Në të njëjtën kohë administrata është duke përditësuar studimin për pyllëzimin e zonës afër liqenit, e cila do të ndihmojë në bashkëpunimin e specieve ujore dhe kafshëve tokësore.

## Menaxhimi i peshkimit të qëndrueshëm

Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të liqenit, veçanërisht i peshkimit dhe turizmit, është një nga komponentët kryesorë të projektit. Një nga partnerët është Organizata për Menaxhimin e Peshkimit (OMP). OMP-ja e Shkodrës është themeluar në 23 Mars 2003 dhe mbulon të gjithë aktivitetet e peshkimit në Zogaj, Shirokë, Rrethina, Vrakë, Valcë, Koplik, Stërbeq, Jubicë, Kamicë dhe Shegan. Ajo luan një rol shumë aktiv në menaxhimin e liqenit, edhe për faktin që licencat e peshkimit u jepen vetëm anëtareve të OMP-së. OMP-ja bashkëpunon me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor dhe MMPAU. Strukturat e tij kryesore janë Këshilli Administrativ dhe Asambleja e Përgjithshme. Detyrat e OMP-se janë:

- ◊ Promovimi i përdorimit të metodave që sigurojnë vazhdimin e zhvillimit të peshkimit në përputhje me legjislacionin për peshkimin, duke përdorur teknologjinë e duhur për kapjen dhe rritjen e peshkut.
- ◊ Promovimi i cilësisë së biodiversitetit të faunës peshkore dhe të shmangë shpërdorimin,
- ◊ Të sigurojë pjesëmarrjen e pjesëtareve në bashkë menaxhimin e burimeve të peshkimit dhe të mbrojtë interesat e tyre.

OMP ka një staf prej 5 personash e këshilli administrativ është i përbërë nga 11 pjesëtar.

Disa nga rezultatet e arritura nga organizata janë:

- Rritja e numrit të licencave për peshkim (210);

- Rënie prej 30% të numrit të peshkimeve ilegale në 2011 krahasuar me 2007;

- Mbrojtja e peshkut në zonat e shtimit të vezëve përgjatë sezonit të ndalimit të peshkimit dhe heqja e mjeteve statike të peshkimit.

- Zhvillimi i një plan biznesi, etj.

Në 2011 u themelua Federata Kombëtare e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit dhe drejtohet nga Kryetari i OMP-së së Shkodrës, Z Gëzim Lezaj. OMP-ja e Shkodrës është i pari entitet i licencuar për tregtimin e ankandin e peshkut.



## Fushata e përbashkët për ndërgjegjësimin e publikut



Në kuadër të projektit për Menaxhimin e Integruar të Liqenit të Shkodrës, Forumi Ndërkufitar i Liqenit të Shkodrës me mbështetjen financiare të Bankës Botërore, nëpërmjet Ministrive respektive të Shqipërisë dhe Malit të Zi zbatuan fushatën: "Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore të liqenit të Shkodrës.

Qëllimi i fushatës ishte të rriste ndërgjegjësimin e komunitetit në të dy anët e projektit dhe ishte e bazuar në tre shtylla kryesore: krijimi i grupit të projektit për implementimin e tij; përcaktimi dhe takimi me grupet e synuara dhe zhvillimi i informacionit – strategjia e

komunikimit me komunitetin. Strategjia e ndërgjegjësimin për mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të liqenit të Shkodrës afron shume aktorë të interesuar në rajon duke përfshirë edhe institucione për menaxhimin e burimeve natyrore siç është edhe Drejtoria Rajonale e Pyjeve, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Parku Kombëtar i Liqenit të Shkodrës, Institucione kërkimore si Universiteti i Shkodrës dhe Tiranës (nëpërmjet kontributit të ekspertëve) dhe institucione të edukimit ("28 Nëntori", "Ismail Qemali", "Shkolla Pyjore", "Ndre Mjeda" shkolla e mesme e Tuzit, Ulqinit dhe Krajës). Zbatimi i Fushatës ka qenë i suksesshëm nëpërmjet kooperimit të Forumit me Drejtorinë Rajonale të Arsimit, marrëveshjeve të përbashkëta me Parkun Kombëtar të Shkodrës dhe planit strategjik të aktiviteteve.

Një arritje e veçantë e fushatës ishte përfshirja e të rinjve në aktivitete si Eko-kamping me pjesëmarrës nga Shqipëria dhe Mali i Zi, aktivitete të përbashkëta pastrimi në brigjet në të dy anët e liqenit veçanërisht pas përmbytjes së Janarit 2011.

Një nga produktet e fushatës ishte kiti për edukimin mjedisor për ekosistemin e liqenit të Shkodrës. Për here të parë ky kit është përgatitur në 3 gjuhë (Shqip, Anglisht dhe Malazeze) dhe për grup moshat 10-18 vjeç. Kiti do të përdoret nga mësuesit në orët ekstra kurrikulare brenda dhe jashtë ambientit të shkollës.

Si vazhdimësi e fushatës dhe në kërkim të vazhdimësisë së qëndrueshme të aktiviteteve në rajon janë ngritur grupe të ekologjistëve të rinj të cilët synojnë forcimin e rrjetit për mbrojtjen e burimeve të përbashkëta. Në të njëjtën kohë Forumi Ndërkufitar i liqenit të Shkodrës do të vazhdojë të punojë në rajon nëpërmjet përfshirjes së grupeve të interesit

## Takimi i Komisionit të Liqenit të Shkodrës

Takimi i katërt i komisionit të liqenit të Shkodrës u mbajt në Shkodër në 7 tetor 2011. Qëllimi i takimit ishte të prezantohej progresi i objektivave të projektit dhe rekomandimet për përmirësim në aktivitetet e ardhshme. Përgjatë takimit u diskutua dhe u aprovuan dokumente të ndryshëm të prodhuara si Modeli Parashikues Hidrologjik, Rishikimi i Kuadrit Ligjor dhe Programi i Monitorimit të përbashkët. Pjesë e programit ishte edhe organizimi i **Takimit të Donatorëve**. Ky event do të organizohet në Nëntor 2011. Takimi synon të paraqesë rezultatet e projektit po aq sa edhe të nxisë shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet donatorëve dhe zonave aktuale të ndërhyrjes.

## Ndërgjegjësimi Publik për të mbrojtur cilësinë e ujit



Creative City në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Bashkia e Shkodrës janë duke organizuar aktivitete pastrimi përgjatë brigjeve të liqenit të Shkodrës çdo të shtunë dhe të diel përgjatë muajit Tetor dhe Nëntor. Këto aktivitete janë pjesë e fushatës së ndërgjegjësimit publik të zonës për të mbrojtur cilësinë e ujit të liqenit. Qëllimi i kësaj fushate është të informojë dhe ndërgjegjësojë komunitetin pranë liqenit për burimet e

rezikshme të ndotjes në liqen. Ajo gjithashtu do të informojë mbi rëndësinë dhe përfitimet nga reduktimi i ndotësve të ujit, e cila do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së ujit dhe rritjen ekonomike në komunitet.

## Udhëtimi në Liqenin e Shkodrës.

Në kuadër të Konferencës së 6 Kombe të Ujit të mbajtur në Dubrovnik, projekti u paraqit me një prezantim dhe pati një vend të vecantë me materiale promovuese në tregun inovativ. Projekti gjithashtu ishte mikpritës i pjesëmarrësve të Konferencës në liqenin e Shkodrës me një udhëtim të mrekullueshëm në terren përgjatë të cilit ata u informuan nga përfaqësues nga zyra Shqiptare dhe Malazeze e zbatimit të projektit lidhur me aspekte të ndryshme të bashkëpunimit duke përfshirë strukturat e dokumentet e përbashkëta në menaxhim.

## Studime e Raporte

Në kuadër të projektit të Liqenit të Shkodrës janë përgatitur dokumente të ndryshme nga konsulent vendas dhe ndërkombëtar. Dokumentet u janë prezantuar dhe shpërndarë institucioneve respektive dhe mund të gjenden në web-site-in e projektit (<http://iss.iwlearn.org/>):

- ◇ Studimi Social-Ekonomik për zonën e Liqenit në Shqipëri dhe në Mal të Zi
- ◇ Modeli Parashikues Hidrologjik i Pellgut të Liqenit
- ◇ Programi i Monitorimit të Zhvillimit
- ◇ Rishikimi i Kuadrit Ligjor
- ◇ Përgatitja e një inventari të përbashkët për lehtësimin e turistëve në zonën e Liqenit në Shqipëri dhe në Mal të Zi.

Dokumente të tjerë janë në proces përgatitjeje dhe konsultimi.

Financuar nga :



**WORLD BANK**



**GLOBAL ENVIRONMENT FACILITY**

Zbatuar nga:



**Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave**



**Ministria e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Turizmit**

Ky publikim është përgatitur nga **Milieukontakt Albania** në kuadër të programit të konsulencës për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të LSIEMP. Milieukontakt Albania është aktive që në vitin 2000. Qëllimi afatgjat i saj është "të zhvillojë një lëvizje të qëndrueshme dhe demokratike të organizatave mjedisore. Kjo do të thotë një lëvizje që ka një dukshmëri të lartë në shoqëri, të jetë e aftë të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të kenë aftësinë të luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar"



**Adresa: Rr: Xhorxhi Martini, Pall. Teuta Konstruksion; Shk.3/8, P.O.Box:1700, Tirane/Albania**  
**valbona.mazreku@milieukontakt.org**